

V E N D I M
Nr.437, datë 26.6.2003

**PËR RRITJEN E SHTESAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË INVALIDITETIT, DHËNË
SIPAS VENDIMIT NR. 381, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtesat mujore mbi pensionet e invaliditetit, si përfitim paaftësie, që u jepen invalidëve, në mbështetje të vendimit nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të rriten 10 për qind.
2. Efektet financiare, në shumën 5 000 000 (pesë milionë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në buxhetin e vitit 2003, zëri “Shpenzime për programe të veçanta”, t’i shtohen 5 milionë lekë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano